



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

# Buletini informativ

- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**

**Janar 2024**

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

### Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e X

Gjatë muajit janar 2024, për gjyqtarët e kësaj gjenerate gjithsej (28 gjyqtarë, prej tyre një nga komuniteti boshnjak dhe një nga ai turk) është realizuar trajnimi praktik në gjykatat ku janë të përcaktuar.

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar gjithsej 20 ditë trajnimi praktik, e cila është realizuar nën mbikëqyrjen e gjyqtarit/mentor.

Në kuadër të këtij trajnimi, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet

gjyqësore të planifikuara për muajin janar duke ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatëse me rastin e praktikës.

Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin Trajnues.

Gjithashtu vijueshmëria e tyre në trajnimin praktik gjatë muajit ka qenë e rregullt dhe me këtë është përmbush trajnimi praktik sipas kalendarit trajnues.

### Trajnimi fillestarë për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e X



Gjatë muajit janar 2024, për 22 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 14 sesione të trajnimit teorik dhe 15 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli: Kodi i Procedurës Penale, duke filluar nga nën moduli: “Aktakuza dhe procedura e shqyrtimit” nga i cili janë realizuar 7 sesione. Temat e shtjelluara nga ky nën modul janë: aktakuza, aktakuza me propozim për paraburgim, elementet e domosdoshme të aktakuzës, ndryshimi, zgjerimi dhe hedhja e aktakuzës, ngritja e aktakuzës, propozimet ndaj kryesve të veprave penale me çrregullime mendore nën ndikim të alkoolit dhe drogës, të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës.

Nga nën moduli: “Procedurat alternative” janë realizuar 2 sesione dhe janë trajtuar temat

lirimi nga dënimi dhe dëshmitarët bashkëpunues..

Në kuadër të nën modulit: “Provat në procedurën penale” janë realizuar 2 sesione me ç rast janë trajtuar: marrja e provave gjatë hetimeve, deklarimi i të pandehurit dhe dëshmia e dëshmitarit si dhe provat e papranueshme.

Në kuadër të nën modulit “Roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor” janë realizuar 3 sesione në të cilat janë diskutuar marrja e drejtpërdrejt në pyetje, marrja e tërthortë dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit, roli i prokurorit në shqyrtimin e dytë gjatë fazës së kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës dhe seancës statusore si dhe roli i prokurorit në shqyrtimin gjyqësor.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikatat më të mira në situatat përkatëse.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Trajnim lidhur me shkathtësitë në menaxhim dhe lidership

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, Programi i OPDAT kanë realizuar trajnimin me temë: “Shkathtësitë në menaxhim dhe lidership”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përfituesit e trajnimit të aftësohen dhe fuqizohen edhe më tej në aftësitë e tyre menaxhuese që përfshijnë punën e tyre në menaxhimin e lëndëve, stafit, prokurorëve, kryeprokurorëve.

Pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë përvoja të ndryshme lidershipi nga ekspertja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Meghan Morrissey, e cila ka ndarë me pjesëmarrësit përvojat në menaxhimin e zyrës së

Kryeprokurorit në Distriktin e Illinois, format e menaxhimit, delegimin e punëve, mbikëqyrja dhe raportimi.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë punuar edhe në grupe punuese, duke simuluar forma të menaxhimit, specifikisht menaxhimi i prokurorëve nga kryeprokurorët.

Përfitues të trajnimit ishin: U.D Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurorët e prokurorisë speciale dhe Themelore, Prokurorë, administratorë dhe staf tjetër udhëheqës nga prokuroritë.



## Seminar: Mbrojtja e interesave të të tretëve dhe të kreditorëve gjatë procesit të konfiskimit pasuror për garantimin e të drejtave reale e atyre të pronësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe garantimin

Më 24 janar 2024, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit regional “Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor përmes forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e kthimit të pasurive”, implementuar nga AIRE Centere dhe RAI Secretariat, mbështetur nga Qeveria Britanike, realizuan seminarin online përmes platformes zoom me teme “Mbrojtja e interesave të të tretëve dhe të kreditorëve gjatë procesit të konfiskimit pasuror për garantimin e të drejtave reale e atyre të pronësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe garantimin”.


Qëllimi i këtij seminari ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me aspektet më të rëndësishme të konfiskimit të pasurive, duke ofruar njohuri të vlefshme dhe duke nxitur diskutime mbi standardet ndërkombëtare, procedurat hetimore dhe kompetencat gjyqësore

në lidhje me proceset e konfiskimit të pasurive.

Gjatë këtij seminari u trajtuan Kompetencat e gjyqtarit gjatë procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit pasuror dhe kushtet kur mund të vendoset konfiskimi si dhe mbrojtja e interesave të të tretëve dhe të kreditorëve gjatë procesit të konfiskimit pasuror për garantimin e të drejtave reale dhe të pronësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Me theks të veçantë u diskutua Gjykimi në mungesë, barra e të provuarit duke krahasuar sistemin ligjor në Shqipëri dhe Kosovë.



Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi nga Kosova ishin 4 gjyqtar dhe 2 prokuror si dhe 1 bashkëpunëtorë profesional nga Prokuroria.





## Vijueshmëria në trajnim në PTF përmes grafikoneve

---




## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve




## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve

Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara-Janar 2024



Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike - Janar 2024



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660